



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva



DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

- *Procesverbal i takimit me qytetarë në kuadër të Diskutimit Publik në lidhje me Draft Rregulloren për Orarin e Punës së Bizneseve që Operojnë në Territorin e Komunës së Podujevës*

Të hënën, më 29/08/2022 duke filluar nga ora 10:00 në Sallën e Kuvendit Komunal të Komunës së Podujevës u mbajt diskutimi publik me qytetarë lidhur me Propozim Rregulloren për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

Të pranishëm në takim ishin Drejtori i DPZHE, z.Vigan Salihu dhe qytetarë të Komunës së Podujevës.

Takimin e hapi drejtori z.Vigan Salihu, ku kërkoj nga të pranishmit që t'i prezantojnë të gjitha mendimet dhe propozimet që ata kanë lidhur me Draft Rregulloren në fjalë. Ai kërkoj që propozimet të jenë të qarta dhe konkrete.

Labinot Breznica, qytetar i Podujevës tha se bizneset duhet të punojnë edhe të dielave, përshkak se në nivel të Kosovës punojnë të gjitha. "Arsyeja që duhet të punojmë është që mos të dalim nga koncepti i Kosovës. Një llapjan pse me shku në Lupq me ble harq dhe bërlllogun me sjell në qytet. Ata që po kërkojnë mos me punu, është se ata nuk janë në gjendje me u'a dhënë një ditë pushimi punëtorëve dhe po mundohen përmes komunës me u'a siguru një ditë pushimi", ka thënë Breznica.

Ymer Hoti nga fshati Bradash tha se kjo le të mbetet në vullnetin e subjekteve. "Ata që dojnë me punu, le të punojnë. Ata që s'dojnë me punu, mos le të punojnë" ka thënë Hoti.

Vehbi Berisha, qytetar nga fshati Batllavë, por që jeton dhe vepron në Angli, tha se nga përvoja që kam në Angli, është në vullnetin e bizneseve, nëse duan të punojnë ose jo.

Nga ana tjetër, Kadri Llaloshi, banor i rr. Ali Ajeti në Podujevë tha që dita e dielë duhet të jetë ditë pushimi në mënyrë që të pushojnë edhe bizneset pak, sepse, sipas tij, asgjë s'mundesh me mbërri për një të diele me punu.

Qazim Pollomi, pronar i kompanisë "Olti Dekor" tha se e drejta e punëtorit shkelet, nëse komuna u'a jep të drejtën me punu të dielën. "Kur shteti na e jep të drejtën me shkel punëtorin, unë kam me shkel", tha Pollomi. Sa i përketë dyqaneve ushqimore, ai tha se duhet të bëhet një rend për me punu.

Avni Dardani, qytetar tjetër i komunës së Podujevës, tha se s'mundemi me qenë më të menqur vetëm ne si komunë e Podujevës ta kemi rregulloren për orarin e punës së bizneseve. Labinot Breznica shtroj pyetjen së çfarë zhvillimi ekonomik mund të bëhet nëse komuna e ndalon me punu të dielën. "Ju doni ta hapni Parkun e Biznesit. Qysh doni ta hapni Parkun e Biznesit, nëse e ndalon të dielen me punu", tha Breznica.

Shefki Zeqiri, qytetar nga fshati Gërdoc, tha se nga 38 komuna të Kosovës, vetëm 4 komuna e kanë në fuqi Rregulloren për orarin e punës së bizneseve, 3 prej tyre e kanë pezulluar, vetëm Podujeva e ka mbajtur. "Këtu përfitues nuk ka. Boni zgjidhje të qëndrueshme. Propozimi vullnetar kish me qenë më i miri, kush don me punu, le të punojë. Kush nuk don, mos të punojë", ka thënë Zeqiri.

Gazmend Miftari, një qytetar tjetër tha se i përfaqëson 90% të bizneseve që janë për mos me punu të dielen përmes petitionit të cilin e kanë organizuar dhe të cilës i janë përgjigjur bizneset.

Mustaf Sejdiu, drejtor ekzekutiv në Park Piazza, tha se qëndrimi i tyre është që të dielen mos të kthehet ajo që ka qenë. "Ne si qendër tregtare na dëmton shumë, sepse kërkesat e brendeve ndërkombëtare që i kemi sjell këtu, janë që të punojnë edhe të dielave dhe mos të ketë kufizime. Mospuna të dielën është humbje e madhe. Nëse kish me qenë në nivel shtetëror është në rregull, por vetëm në nivel lokal është problem, sepse nuk po dim s'i me ju arsyetu brendeve nacionale për shkak se nuk po na kuptojnë. Ne e kemi dërgu kërkesën për me punu dhe ky është qëndrimi jonë si qendër", ka thënë Sejdiu.

Pas një mori diskutimesh që u bënë mes të pranishmëve, drejtori z.Vigan Salihu, u'a përsëriti atyre se rregullorja për orarin e punës së bizneseve e parasheh nëse dyqani është i hapur ose

jo, nuk e trajton qështjen e punëtorëve. Ai po ashtu bëri me dije se do të marrë një interpretim ligjor nga niveli qendror sa i përketë vendimit për mbylljen e bizneseve, sepse sipas Ligjit të Konkurrencës së Lirë, nëse merret vendim për mbyllje do të bëjmë shkelje ligjore.

Krejt në fund të pranishmëve ju bë e qartë se deri me datë 15 shtator 2022, Draft Rregullora për orarin e punës së bizneseve është në diskutim publik dhe të gjitha sygjerimet që ata kanë mund të i adresojnë përmes emailit të publikuar në web faqe të komunës.

NR : 15-300/01-0074964/22

Data:


29/08/2022

Mbajtësi i procesverbalit:

Mimoze Restelica Sejdiu







Kuvendi i Komunës Podujevë

